



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete, e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **31.1.2023**, me fillim në orën **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, **z. Bajram Morina**.

Kryesuesi: Fillimisht përshëndetje për të gjithë, faleminderit për praninë tuaj! Përshëndetje për Shefin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, z.Lendrit Qeli, përfaqësuesit të KFOR-it, OSBE-së, zv. kryesuesit, përshëndetje për anëtarët dhe të gjithë të pranishmit. Ky është takimi i parë për vitin 2023. Për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

- 1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i raportit të punës për vitin 2022;**
- 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës të Komunitetit për Komunitete për 2023;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë unanime procesverbali kalon.

2. Shqyrtimi i raportit të punës për vitin 2022;

Kryesuesi: Komiteti për Komunitete, gjatë vitit 2022, ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. I kemi realizuar dy vizita në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Liria”, në Fortesë dhe në atë “Hamëz Thaqi”, në Xërxë. Në takimin e parë, është propozuar zgjedhja e kryesuesit me procedurat e parapara me ligj. Në garë ishin Dushan Stanojeviq dhe Bajram Morina. Me 6 vota pro, Bajram Morina është zgjedhur kryesues. Ndërsa si zv. kryesues me 7 vota pro, u zgjodh Dushan Stanojeviq. Në takimin e dytë, të mbajtur më 13 prill 2022, ku pati një kërkesë për shefin e Zyrës së Komitetit për Komunitete rreth mbështetjeve të familjeve që kanë nevojë për strehim. Mbledhja e tretë me 9 qershor 2022, në fushën e arsimit, morëm informatë nga shefi i ZKK-së, se në Komunën e Rahovecit, nxënësit e komunitetit rom(3), ashkali (77) dhe egjiptianë (20), që vijnë në procesin mësimor, janë gjithsej 100. Sa i përket komunitetit serb, janë gjithsej 127 nxënës. Zyra për komunitete, mban fushatë sensibilizuese për regjistrimin e fëmijëve në klasë të parë, në bashkëpunim me organizatën Voice of Roma, Ashkali and Egyptian, e cila ndihmon edhe me bursa nxënësit tanë. Me organizatën IOM, jemi duke bashkëpunuar për formimin e një qendre në shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Gëzim Hamza – Piktori”, me kosto 20.750 euro inventarizim. Pra, kemi pranuar informata se ku ka pasur investime në vendbanimet e komunitetit joshumicë. Mbledhja e katërt, është mbajtur me 9 shtator 2022, është diskutuar rreth vaksinimit të fëmijëve të komunitetit joshumicë (e kemi një raport 6 - mujor) 0-11 muaj, janë 18 fëmijë të vaksinuar, 12-23 muaj, janë 19 fëmijë të vaksinuar, 24-59 muaj, janë 11 fëmijë të vaksinuar. Në takimin e pestë, të mbajtur me 31 tetor 2022, është diskutuar rreth themelimit dhe funksionimit të qendrës mësimore të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Katër Dëshmorët” në Ratkoc, duke u bazuar në UA që ka viti 2020. Më pas u diskutua edhe rreth vërsimeve të fundit ku jeton komuniteti joshumicë. Sipas komisionit dëmet janë: 1 rast në Ratkoc, 1 rast në Xërxë, 3 raste në Celinë, 1 në qytet. Në takimin e gjashtë, të mbajtur me datë 29 dhjetor 2022, u diskutua rreth informatës rreth realizimit të vizitave të realizuara në

shkollat ku vijojnë mësimin komuniteti joshumicë, rreth vizitës në Shkollën e Mesme të Ulet, në Fortesë dhe në atë "Hamëz Thaqi", në Xërxë. Këto ishin të gjitha aktivitetet që i kemi mbajtur në vitin 2022.

Faleminderit për vëmendje!

Shqipe Kryeziu: Përshëndetje! Faleminderit për këtë raport shumë të qartë, uroj të vazhdoni tutje!

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës të Komunitetit për Komunitete për 2023;

Kryesuesi: Secili prej jush e ka para vetës nga një kopje fizike të Planit të Punës për viti 2023.

Objektivat: Miratimi i Planit të Punës për 2023 dhe përpilimi i Raportit Vjetor të Punës për 2022. (janar 2023). Përcjellja e punës dhe promovimi i të drejtave të komuniteteve (janar - dhjetor). Vizitë vendbanimeve dhe shkollave ku jeton komuniteti joshumicë (mars – maj). Takime me drejtorë të departamente të ndryshme (qershor – shtator 2023), përdorimi i gjuhëve zyrtare në institucionet publike (janar – dhjetor), zbatimi i strategjisë (2021 - 2025) për integrimin e komunitetit joshumicë, në shoqërinë e Kosovës (maj – shtator), shqyrtimi i raporteve të organeve relevante (janar – dhjetor). Përgatitja e Raportit të punës 2023 dhe e Planit të Punës 2024 (dhjetor 2023).

Skender Hamza: Përshëndetje për të pranishmit! Sa për informacion, ky plan, pas aprovimit nga ana e juaj, do të votohet në Kuvend të Komunës në muajin shkurt. Nëse keni ndonjë pikë shitesë brenda këtyre 10 ditëve, derisa materiali të shkojë në kuvend, mund të na kontaktoni në e-mailin zyrtar.

Kryesuesi: Atëherë po e vendos në aprovim. Kush është "për"?... Konstatohet që në mënyrë unanime është aprovuar Plani i Punës për vitin 2023.

4. Të ndryshme;

Edonë Kryeziu: Përshëndetje kryesues, gjithë të pranishëm! Në njërin prej seancave të mbajtura, si shqetësim i kam shfaqur sfidat në sistemin e arsimit. Realisht nuk kam marrë përgjigje nga ju. E di që në komunën tonë ekziston një ekip për reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë. Më intereson ta di që ju si zyrë, sa jeni duke punuar rreth kësaj çështjeje. Përfundimisht, edhe unë personalisht, si anëtarë e komisionit, jam në gatishmëri që t'ju ndihmoj në këtë drejtim.

Kryesuesi: Faleminderit Edona! Do të përgjigjem aq sa kam informacione. E di që ekipi për parandalime dhe braktisje në Komunën e Rahovecit është funksional. Ne si anëtarë të Komitetit për Komunitete kemi zgjedhur komisionin për dalje në terren dhe do të punojmë sipas planit të punës për këtë vit.

A ka edhe dikush tjetër ndonjë gjë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë konstatoj se takimi ka përfunduar.

Mbledhja përfundoi: 10:50

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi



Kryesuesi i mbledhjes:

Bajram Morina